



STATUTI DHE AKT THEMELIMI I SHOQËRISË “ALBSOL” SH.P.K.

(Shoqeri me Përgjegjesi të Kufizuar)

Në bazë të ligjit 9901, datë 14.04.2008 “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregtare”, dhe, ligjit Nr.9723, datë 3.5.2007 I Ndryshuar “Per Regjistrimin e Biznesit” i nënshkruari shpall si më poshtë vijon:

Neni 1 FORMIMI I SHOQËRISË

Sot ne daten 25.09.2023 formohet shoqëria e quajtur “ALBSOL” SH.P.K. (Qe ketu e me poshte referuar si “Shoqëria”, e cila themelohet nga Ortaket si me poshte:

Z.Artan Shima, shtetas shqiptar, i biri i Gezim, lindur me 19.10.1977 ne Tirane, banues ne adresen: Rr: “Rr Myslym Shyri ”, Njesia 10, Pall. 117/1, Ap. 5, Tirane, i pajisur me karten e identitetit Nr. 025679502, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.

dhe

Z.Enea Andrea , shtetas shqiptar, i biri i Thoma, lindur me 18.08.1971 ne Tirane, banues ne adresen: Rr: “Rr Ndre Mjeda , P49, H1, Ap 17, kodi postar 1023” , Tirane, i pajisur me karten e identitetit Nr.038790339 , madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Neni 2 QENDRA E SHOQËRISË

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresen: Ura e Limuthit, Bërxull, **Bashkia Vore, Tirane, Shqiperi.**

Shoqëria ka te drejte te hape dege apo filiale, zyra perfaqesimi, ne te gjithe

vendin gjate aktivitetit te saj, brenda ose jashte territorit te vendit.

Neni 3

KOHËZGJATJA E VEPRIMTARISË EKONOMIKE

Kohëzgjatja e aktivitetit të Shoqërisë do të jetë pa afat, duke filluar që prej datës së regjistrimit të saj në Qendren Kombetare të Bisnesit (QKB).

Shoqeria mund të perfundojë, të vihet në likuidim përpara këtij afati aktivitetin e saj me vendim të Asamblese së Ortakeve.

Neni 4

OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË

Shoqeria ka për objekt veprimtarite e mëposhtme:

- Studim, projektim, zbatim, prodhim dhe tregtim i energjise elektrike nga burime alternative si sistemet fotovoltaike, parqet e eres, termocentralet, biomasa etj.

- Implementimi dhe menaxhimi i projekteve gjeneruese (fotovoltaike, eolike, hidrike) të energjise elektrike, të cilat shfrytëzojnë burimet e rinovueshme të energjise elektrike si dielli, era, uji si dhe i veprave të tyre ndihmese. Përfshirë dhe pa u kushtezuar vetëm në marrjen e të gjitha lejeve, licensave dhe autorizimeve paraprake/perfundimtare, institucionet përgjegjëse shtetërore (qofshin këto organe Qendrore apo Vendore), apo private të cilat mundësojnë zhvillimin e këtyre aktiviteteve në mënyrë të qetë dhe në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

- Shitja me shumice dhe pakice e energjise elektrike tek operatorët, furnizuesit, tregtarët, konsumatorët e energjise elektrike (vendas apo të huaj), si dhe në Bursën Shqiptare të Energjise Elektrike (ALPEX), apo Bursa të tjera të energjise jashtë vendit.

Përveç sa më sipër, Shoqeria mund të kryejë çdo aktivitet që lidhet direkt ose indirekt, që është rezultat ose lidhet me objektin e mesiperm. Për arritjen e qëllimit të mesiperm, Shoqeria mund të kryejë çdo transaksion lidhur me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, dhe çdo aktivitet tjetër tregtar, financiar, qiraje ose hipoteke, që mund të konsiderohet i vlefshëm ose i nevojshëm në mënyrë që të ushtrohet objekti i Shoqërisë. Duke përfshirë por pa u kufizuar në linjat elektrike të tensionit të lartë dhe të mesëm, nënstatione





elektrike dhe njesi te tjera te lidhjeve elektrike, rrugeve te aksesit etj., si dhe cdo aktivitet aksesor i lidhur me sa me siper, si punime germimi, punime per prishjen dhe punime te tjera te tokes, punime civile, elektrike dhe mekanike te cdo lloji si dhe blerje, shitje, shkembim, import-eksport te pajisjeve, riparim dhe mirembajtje te materialeve dhe pajisjeve dhe te gjithe aktivitetet e lidhura me keto ceshtje, gjithashtu dhe ne fushen e aktiviteteve te tregtimit.

Neni 5 EMRI DHE SELIA E SHOQERISE

Kjo shoqëri eshte person Juridik Privat me emertimin e saj ALBSOL SH.P.K. Shoqeria mund të ndryshojë emërtimin e saj, vendqëndrimin, objektin e aktivitetit, të shtojë ortakë, të rrisë kapitalin sipas vendimeve të Ortakeve .

Neni 6 KAPITALI I SHOQERISE

Kapitali fillestar i shoqerise është 100.000 (njqind mije) leke i perbere nga dy kuota me te njejten vlere por asnjehere me pak se 100.000(njqind mije) leke, zoteruese 100% te kapitalit te shoqerise.

Kapitali zotërohet 100% nga ortakët si me poshte :

Z. Artan Shima, shtetas shqiptar, i biri i Gezim, lindur me 19.10.1977 ne Tirane, banues ne adresen: Rr: “Rr Myslym Shyri ”, Njesia 10, Pall. 117/1, Ap. 5, Tirane, i pajisur me karten e identitetit Nr. 025679502 , madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar i cili zoteron 50 % te kapitalit fillestar

Dhe

Z.Enea Andrea , shtetas shqiptar, i biri i Thoma, lindur me 18.08.1971 ne Tirane, banues ne adresen: Rr: “Rr Ndre Mjeda , P49, H1, Ap 17,Kodi postar 1023, Tirane, i pajisur me karten e identitetit Nr.038790339 , madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar i cili zoteron 50 % te kapitalit fillestar.

Ortakët mund te vendosin te rrisin kapitalin e shoqerise ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi dhe me vendim te Ortakeve. Detyrimet e ortakut



kundrejt shoqerise do te mbulohen vetem me pjesen e kapitalit te paguar prej tij. Ortaku nuk do te kete asnje pergjegjesi tjeter per detyrime te tjera te shoqerise.

Shoqeria nuk pergjigjet per detyrime te marra per qellime qe nuk perputhen me ato te paracaktuara nga ky Statut, si edhe per detyrime te marra nga Ortaku ne emrin e tij personal.

Neni 7 REGJISTRIMI I SHOQERISE

Shoqëria tregtare deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave që përmban ky Statut si dhe të legjislacionit shqiptar në fuqi. Ajo konsiderohet e krijuar në datën e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Bisnesit (QKB) sipas nenit 43 te ligjit 9723 date 3.5.2007.

Neni 8 KALIMI I KUOTAVE DHE E DREJTA E PARABLERJES

Kuotat e kapitalit te shoqerise si dhe te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo te kalohen nepermjet :

- a) kontributit ne kapitalin e shoqerise
- b) shitblerjes se kuotave
- c) trashegimise
- d) dhurimit
- e) cdo menyre tjeter te parashikuar ne ligj.

Personi qe kalon kuoten dhe ai qe fiton ate pergjigjen ne menyre solidare ndaj shoqerise per detyrimet qe rrjedhin nga zoterimi i kuotes nga casti i kalimit te kuotave deri ne castin e regjistrimit te kalimit.

- Pjeset e kapitalit mund t'u transferohen te treteve teresisht ose pjeserisht, vetem me vendim te Ortakeve te shoqerise.
- Transferimi per cfaredo arsyeje, teresisht ose pjeserisht i pjeseve te kapitalit te Shoqerise eshte subjekt i se drejtes se parablerjes ne favor te ortakeve te tjere, te cilet mund te ushtrojne kete te drejte ne raport me

pjeset e tyre te kapitalit, brenda 30 (tridhjete) ditesh nga marrja e njoftimit te derguar me leter rekomande. Ne kete njoftim duhet te saktosohet cmimi i kerkuar, i cili duhet te jete i arsyeshem dhe i njejte me ate qe do ti ofrohet nje personi te trete, jashte shoqerise. Ne rast se ortaket e tjere nuk pergjigjen brenda afatit te parashikuar, konsiderohet se ata kane hequr dore nga ushtrimi i te drejtes se parablerjes.

- Ne rast se njeri prej ortakeve refuzon ose heq dore nga ushtrimi i te drejtes se parablerjes, ortaket e tjere, te cilet tashme kane ushtruar te drejten e tyre te parablerjes, mund ta riperdorin kete te drejte edhe per pjesen e ofruar ortakut qe e refuzoi ate.
- Ne rast se me shume se nje ortak deshiron te riperdore te drejten e parablerjes, pjeset e kapitalit te ofruara ortakut qe nuk deshiron te ushtronte te drejten e tij, ndahen proporcionalisht me pjeset e kapitalit respektiv.
- Ne rast se vetem njeri prej ortakeve deshiron ta ushtroje te drejten e parablerjes, pjesa e kapitalit te ofruar i trasferohet atij teresisht ose ne ate mase qe ky ortak deshiron.
- Per kete qellim, ortaket qe deshirojne te riperdorin te drejten e tyre te parablerjes duhet te njoftojne vendimin e tyre ortakut qe deshiron te trasferoje pjeset e tij te kapitalit brenda 15 (pesembedhjete) ditesh qe prej marrjes se lajmit per mos ushtrimin e te drejtes se parablerjes prej ndonjerit prej ortakeve.
- Te gjitha njoftimet e siperpermendura do te behen me shkrim dhe i adresohen Administratorit te Shoqerise

Neni 9

Emertimi i shoqerise tregtare, kapitali themeltar, emri i administratorit, duhet te jete te permendura ne te gjitha aktet e nxjerra nga kjo shoqeri dhe qe ju drejtohen te treteve. Shoqeria ka vulen e saj me madhesi te zakonshme dhe me permbajtjen perreth saj.

Neni 10

Shoqeria vepron nen regjimin e prones private dhe merr persiper vete te drejtat





dhe detyrimet kontraktore

Organet e shoqerise jane:

- 1- Asambleja e Ortakeve te Shoqerise
- 2- Administratori/et

Neni 11 KOMPETENCAT E ORTAKEVE

Per menyren e drejtimit dhe ushtrimit te aktivitetit te shoqerise, Ortaket shprehen me vendime per gjithshka qe eshte ne kompetencat e tyre te pershkruara si me poshte:

- Kane te drejte te bejne ndryshime ne statut.
- Percaktojne politikat tregetare te shoqerise
- Kane të drejtë të miratojnë bilancin e shoqerise dhe te bejne ndarjen e fitimit.
- Ata emerojne ose shkarkojne administratoret, likujduesit ekspertet kontabel te autorizuar.
- Mbikeqyrin zbatimin e politikave tregetare nga administratoret, perfshire pregatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve te ecurise se veprimtarise
- Miratimin e pasqyrave vjetore dhe raporteve te ecurise se veprimtarise.
- Miratojne zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit.
- Percaktojne shperblimin per administratorin, ekspertet, revizoret kontabel.
- Miratojne pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre.
- Perfaqesojne shoqerine ne gjykate dhe kryejne procedimet e tjera ndaj administratoreve.
- Kryejne riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.
- Miratojne rregullat procedurale te mbledhjeve te asamblese.
- Miratojne lidhjen e kontratave per dhenie dhe marrje te drejtash ose ekskluzivitet per tregtimin dhe prodhimin e mallrave te shoqerise si dhe kontrata ne lidhje me organet shteterore per pjesmarrjen ne tender,



- ankande ose aktivitete te tjera te rendesishme.
- Realizojne blerje, shitje si dhe tjetersim te pasurive te palujtshme te shoqerise etj.
 - Etj.

Neni 12

VENDIMET E ASAMBLESE

Marrja e vendimeve te Ortakeve regjistrohen ne regjistrin e vendimeve te Ortakeve , mbajtja e procesverbaleve dhe te gjitha dokumentat e tjera qe kane te bejne me te duhet te behen sipas legjislacionit ne fuqi per kete qellim.Vendimet e paregjistruara ne regjistrin e vendimeve jane absolutisht te pavlefshem .

Neni 13

THIRRJA E ASAMBLESE

Asambleja e pergjithshme thirret sa here qe shte e nevojshme per te mbrojtur interesat e shoqerise. Mbledhja e zakonshme e asamblese se pergjithshme thirret te pakten nje here ne vit.

Asambleja e pergjithshme thirret nga Adminsitratoret ose nga ortaket te cilet perfaqesojne te pakten 5 % te totalit te votave ne Asamblene e Pergjithshme te Shoqerise .

Asambleja e Pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose nepermjet postes elektronike 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese. Njoftimi ne te dyja formate e mesiperme duhet te permbaje vendin, daten ,oren e mbledhjes dhe rendin e dites.

Neni 14

PJESEMARRJA NE VENDIME

Cdo ortak, ne rastet kur shoqeria do te kete me shume se nje ortak, ka te drejte te marre pjese ne vendime si dhe disponon nje numer votash te barabarte me

pjeset e kapitalit themeltar qe ai zoteron.

Ne rastin e marrjes se vendimeve qe kerkojne nje shumice te zakonshme, Asambleja e Pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket te cilet perfaqesojne me shume se 61% te kuotave me te drejte vote. Ne rastin kur ky kuorum nuk arrihet ne thirrjen pare, Asambleja e ortakeve do te thirret serish me te njejtin rend dite brenda dhe jo pertej 30 (tridhjetë) diteve duke filluar nga thirrja e pare.

Merren vlefshmerisht me voten pro te ortakeve qe perfaqesojne 75% (shtatedhjetepese perqind) te kapitalit te shoqerise, vendimet qe kane si objekt ceshtjet ne vijim:

- ndryshimet e statutit;
- rritja dhe zvogelimi i kapitalit te Shoqerise;
- transformimi i Shoqerise;
- miratimi i projekteve te bashkimit dhe ndarjes;
- shperndarja e dividendeve;
- autorizimi i blerjes se pronave te ortakeve dhe te administratoreve;

kontrata me pale te nderlidhura, duke kuptuar si te tilla, per ilustrim dhe jo listim, familjare dhe te aferm te secilit prej administratoreve dhe menaxhereve te Shoqerise, ketu perfshire edhe percaktimi apo rregullimi i kompensimeve qe i perkasin ketyre subjekteve

Merren vlefshmerisht me voten pro te ortakeve qe perfaqesojne 75% (pesedhjetepese perqind) te kapitalit te Shoqerise vendimet qe kane si objekt ceshtjet ne vijim:

- miratimin e pasqyrave financiare
- revokimi i administratoreve dhe percaktimi i kompetencave te tyre;
- aprovimi i planeve te marketing-ut dhe te buxheteve vjetore;
- aprovimi i business plan-eve disa-vjecare te Shoqerise dhe, ne menyre me te pergjithshme, te linjave strategjike dhe te drejtimit te aktiviteve te Shoqerise dhe te shoqerive te kontrolluara prej saj;



- marrevshjet e joint venture te cilat parashikojne angazhime financiare, te partnership-it , dhe forma te tjera bashkepunimi me ndermarrje te tjera, sikurse edhe marrevshje ortakesh te cdo lloji;
- operacione financimi per shuma te cilat tejkalojne 250000(dyqind e pesedhjete mije) euro per nje transaksion te vetem dhe per nje totale euro 500000(peseqind mije);
- cdo operacion qe ka si objekt prona te paluajtshme dhe cdo e drejte qe ka te beje me to, ketu perfshire blerja, cedimi, shkembimi, marrja me qira dhe vendosja e garancive mbi keto prona;
- cdo operacion qe ka si objekt pronat e luajtshme, edhe te regjistruara, me vlere me te larte se euro 200000 (dyqind mije), ketu perfshire aktet e disponimit dhe te vendosjes se garancive;
- kontrata lidhur me blerjen, transferimin, licencen aktive apo pasive te patentave, know-how , marka, te drejta te regjistruara per shpikje industriale, modele, vizatime ornamentale dhe shenja dalluese apo cdo akt tjetër disponimi te te drejtave te pronesise intelektuale ose industriale, perjashtuar perdorimi i software-ve ;
- vendosja e garancive reale apo personale ne favor te te treteve;
- doreheqja nga garanci te leshuara nga te trete ne favor te Shoqerise;
- marrja ne pune si dhe heqja nga puna e personelit vartes si dhe atij drejtues me page vjetore e cila tejkalon euro 60000 (gjashtedhjete mije);
- themelimi dhe rikapitalizimi i shoqerive ku Shoqeria zoteron pjesemarrje, shoqerive, dhe i entiteteve te tjera;
- blerje apo cedime te pjeseve te kapitalit te shoqerive dhe degeve te ndermarrjeve, sikurse edhe qiraja aktive dhe pasive e ketyrte fundit, konferimi i degeve. te ndermarrjeve dhe investime, jashte cka eshte parashikuar ne business plan-et e aprovuar nga Asambleja;
- dhenia e financimeve shoqerive Shoqeria zoteron pjesemarrje per shuma totale, ne baze vjetore, qe tejkalojne euro 200000 (dyqind mije);
- akte te tjera, te ndryshme nga ato te siperpershkuara, te cilet





sjellin nje detyrim shpenzimesh apo e ekspozojne Shoqerine per shuma te cilat tejkalojne euro 200000 (dyqind mije)

Neni 15 ADMINISTRIMI

Shoqeria administrohet nga dy Administratore te cilet caktohen ne statutin e shoqerise dhe me pas nga Vendimet e Ortakeve apo nga Asambleja e Ortakeve ne rast se shoqeria do te kete me shume se nje ortak. Administratori/et qendron ne detyre per nje periudhe jo me te gjate se 5 vjet me te drejte ripërteritje kohore dhe ne rast se gjate kesaj periudhe shfaqen probleme paaftesie nga ana e tij, Ortaket vendosin shkarkimin e tij per shkaqe te arsyeshme.

Administratori/et detyrohet te kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregetare te shoqerise duke zbatuar politikat tregetare te vendosura nga asambleja e pergjithshme.

Ai kujdeset per mbajtjen sakte dhe te rregullt te dokumenteve,dhe te librave kontabel te shoqerise.

Ai pergatit dhe nenshkruan bilancin vjetor te shoqerise ,bilancin e konsoliduar dhe raportin e e curise se veprimtarise, dhe se bashku me me propozimet per shpernarjen e fitimeve i paraqesin keto dokumente para asamblese se pergjithshme per miratim.

Ai ka te gjitha kompetencat per te vepruar me tretet ne emer te shoqerise dhe ne interes te saj ne te gjitha rrethanat me perjashtim te kompetencave qe ligji dhe Statuti i shoqerise u'a jep shprehimisht Ortakeve .

Administratori ka te drejte te nenshkruajne per kapitalin e shoqerise, kontrata te ndryshme, per furnizime publike private, cdo lloj operacioni bankar, te veproje me cdo lloj instituti bankar publik e privat, te ndermarre veprime gjyqesore, transaksione te ndryshme, etj. Administratori mund te japi prokura ne kufijte qe i lejon Asambleja e Ortakeve per kategori te caktuara veprimesh.

Te gjitha veprimet e tjera duke perfshire pagesa dhe detyrime per tu paguar ose veprime me insitucionet bankare ku perfshihen transferta bankare dhe terheqje parash qe do te ndermerren nga Administratori per llogari te shoqerise, eshte e

nevojshme dhe e detyrueshme nenshkrimi i Administratorit se bashku me vullen e shoqerise, ne menyre qe keto veprime te jene te detyrueshme per shoqerine.

Administratori/et nuk mund te kryejne pa miratimin e Asamblese se Pergjithshme:

- Lidhje kontratash qe kalojne shumen prej euro 50,000 (pesedhjetë mijë) ne nje kontrate te vetme dhe shumen euro 20,000 (njëzet mijë) per nje muaj;
- Lenien peng ose ne hipoteke te pasurive te shoqerise;
- Shit-blerje te pasurive te paluajteshme ne pronesi te Shoqerise;
- Te kontraktoje ne cfaredo lloj forme qofte, te marri hua tek shoqeria, te japi pelqimin ne emer te saj per parardhnie si dhe te behet dorezanes apo te garantoje ne emer te saj angazhimet ndaj te treteve

Administratoret e Shoqerise te cilet veprojne ne menyre solidare jane si me poshte ;

Z.Artan Shima, shtetas shqiptar, i biri i Gezim, lindur me 19.10.1977 ne Tirane, banues ne adresen: Rr: "Rr Myslym Shyri ", Njesia 10, Pall. 117/1, Ap. 5, Tirane, i pajisur me karten e identitetit Nr. 025679502 , madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.

dhe
Z. Enea Andrea, shtetas shqiptar, i biri i Thoma, lindur me 18.08.1971 ne Tirane, banues ne adresen: Rr: "Rr Ndre Mjeda , P49, H1, Ap 17,Kodi postar 1023, Tirane, i pajisur me karten e identitetit Nr.038790339 , madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Administratoret ne banke mund te veprojne ne menyre te pavarur sipas kompetencave te administrimit te percaktuara si me siper ne kete nen.

Ata do ta ushtrojne kete detyre per nje periudhe 5 vjecare.

Neni 16
MARREDHENIET E PUNES



Mardheniet e punes rregullohen nepermjet kontrates se punes dhe legjislacionit te punes ne fuqi. Shoqeria merr persiper te respektoje rregullat ne fuqi te punesimit dhe te punesuarit jane te detyruar qe te respektojne Statutin e kesaj shoqerie dhe rregullat e brendeshme te saj. Te punesuarit duhet te pergjigjen per demet qe i shkaktojne kesaj shoqerie nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.

Neni 17

KONFIDENCIALITETI, RUAJTJA E SEKRETIT

Konsiderohen si konfidenciale dhe nuk lejohet te behet publike permbajtja e tyre per te tretet e te gjitha akteve dhe dokumentave qe jane percaktuar si te tilla nga administratori i shoqerise.

Neni 18

EKSPERTET OSE REVIZORET KONTABEL

Kontrolli mbi veprimtarine e shoqerise si dhe gjithe aktivitetin e shoqerise i besohet nje eksperti ose revizori kontabel. Ky ekspert do te qendroje ne detyre per aq sa percaktohet me ligj dhe mund te rizgjidhet. Ortaket caktojne dhe shperblimin perkates kur nuk ka norma te vecanta ligjore.

Neni 19

VITI FINANCIAR, SHPËRNDARJA E FITIMEVE

Viti financiar fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 dhjetor të secilit vit. Administratori/et marrin masat lidhur me perlllogaritjen e rezultateve ekonomike te fitimeve apo humbjeve dhe inventarizimin. Pas analizimit te ceshtjeve te mesiperme si dhe shlyerjen e detyrimeve, te ardhurat e tjera do ti kalojne ortakut te shoqerise.

Neni 20





SHPERNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE

Ne rast se shoqeria shperndahet per cdo lloj arsye Ortaket percaktojne menyren e likuidimit, emerone nje ose me teper likuidator dhe pergatitin te gjitha dokumentet e nevojshme per c'regjistrimin e saj nga Qendra Kombetare e Regjistrimit.

NENI 21 ZGJIDHJA E MOSMARRVESHJEVE

Te gjitha mosmarreveshjet qe mund te lindin me interpretimin dhe/ose zbatimin e ketij Statuti do te zgjidhen me mirkuptim dhe do te diskutohen ne menyre te drejperdrejte midis paleve te interesuar.

Ne rast se nuk do te arrihet nje zgjidhje me mirkuptim te mosmarrveshjes, ajo do ti besohet Gjykates se Rrethit Tirane.

Neni 22 DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Persa eshte shprehur ne kete statut i referohemi ligjit 9901, date 14.04.2008 "Per tregetaret dhe shoqerite tregtare" dhe ligjit Nr.9723, date 3.5.2007 I Ndryshuar "Per Regjistrimin e Biznesit". Cdo ndryshim behet ne perputhje me kete Statut dhe nuk prek personalitetin juridik te kesaj shoqerie.

Statuti eshte hartuar ne 4 kopje origjinale ne gjuhen shqipe.

ORTAKET E SHOQERISE "ALBSOL"SH.P.K.

Z. Artan SHIMA

ARTAN SHIMA

Z. Enea ANDREA

Enea Andrea